



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS NOVOBËRD

Numri i lëndës: 2023:121274

Datë: 20.03.2025

Numri i dokumentit: 07019629

C.nr.90/2023

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-DEGA NË NOVOBËRDË, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Gazmend Ajvazi, me bashkëpunëtoren profesionale Laureta Shala, në çështjen juridiko-civile, sipas padisë së paditëses E. J. nga Gjilani, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit Hamdi Jashari, avokat nga Gjilani, kundër të paditurve A.S. dhe M. S. me objekt kontesti, vërtetimi i të drejtës së pronësisë, jashtë seancës gjyqësore më datë 18.03.2025 mori këtë,

A K T V E N D I M

I.KONSIDEROHET- e tërhequr padia e paditëses E. J. nga Gjilani, e paraqitur ndaj të paditurve A. S. dhe M. S., me objekt kontesti, vërtetimi i të drejtës së pronësisë.

II. Obligohet paditësja në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, të paguaj taksën gjyqësore për ushtrim të padisë, në shumën prej 20€, konform U.A. nr.1/2017, për Unifikimin e Taksave Gjyqësore.

III. Obligohen të paditurit, që në emër të shpenzimeve gjyqësore paditëses t'ia, paguaj shumën prej 20€, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Paditësja, përmes të autorizuarit të saj, në këtë gjykatë më datë 30.05.2023, ka paraqitur padi ndaj paditurve A.S. dhe M. S.

Gjykata pas shqytimit paraprak të padisë, me aktvendimin e dates 21.11.2024, e ka kthyer në plotësim padinë e paditëses në lidhje me përcaktimin e adresës së saktë të të paditurve, rrugën, numrin, lagjen, qytetin ose dokumentin nga institucionet kompetente për adresën e fundit të të paditurve në territorin e Republikës së Kosovës.

Andaj në rastin konkret paditësja nuk e ka plotësuar, gjegjësisht nuk ka vepruar sipas aktvendimit të datës 21.11.2024, me të cilën është urdhëruar që brenda afatit ligjor të bëjë përcaktimin e adresës së të paditurve, gjykata vendosi që padia e paditëses të konsiderohet e tërhequr.

Gjykata duke u bazuar në nenin 102 pika 3 të LPK –së ku shprehimisht parashihet se “Do të konsiderohet se është tërhequr parashtrësia po që se nuk i kthehet gjykatës brenda afatit të caktuar, e në qoftë se i kthehet pa u korrigjuar, gjegjësisht pa u plotësuar, parashtrësia do të hidhet poshtë.

Andaj në rastin konkret pasi që paditësi nuk e ka plotësuar padinë, vendosi që padia e paditëses E. J. të konsiderohet si e tërhequr.

Nga të cekurat më lart, në bazë të nenit 102.3, 142, të LPK-ës, Gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN- DEGA NË NOVOBËRDË
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil
C.nr.90/2023, më datë 18.03.2025

Gjyqtari
Gazmend Ajvazi

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi pala e pakënaqur mund të ushtroj ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktvendimi në Gjykatën e Apelit në Prishtinë. Ankesa në kopje të mjaftueshme dorëzohet përmes kësaj gjykate.